



Prishtinë: 20.11.2011

Kodi i ZRRE-së: V_392_2011

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_696_12_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Nenin 18 të Rregullës për Procedurën e Zgjidhjes së mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_696_12_11**;

Në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2011 nxori këtë:

VENDIM

APROVOHET ankesa e konsumatorit Ruzhdi Kadriu (Interpress Company me shifër në KEK: DPR - 90054823) nga Prishtina si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 31.05.2011 ka kundërshtuar përgjigjen e KEK-ut të datës 06.05.2011 lidhur me borxhin si dhe shkyçjen nga rrjeti elektrik pa paralajmërim.

- Me datë 12.02.2009 konsumatori ka parashtruar kërkesë zyrtare në KEK për regjistrimin e njehsorit elektrik.
Provë: Kërkesa për regjistrimin e njehsori t me datë 12.02.2009
- Me datë 10.03.2009 KEK-u i ka lëshuar konsumatorit Ruzhdi Kadriu "CITY Hipermarket" Pëlqimin elektronenergjetik, ku matja e energjisë elektrike të bëhet me njehsor multifunksional (aktive, reaktive dhe maksigraf) i lidhur nëpërmes TMRR 300/5 A/A.
Provë: Pëlqimi elektronenergjetik nr. 84/ 2009 i datë 10.03.2009
- Me datë 25.03.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit dhe kanë evidentuar të dhënat teknike të pikës matëse si dhe kanë udhëzuar konsumatorin që brenda 3- 5 dite të dorëzoj pëlqimin elektroenergjetik me qëllim që legalizimi i matjes të bëhet sipas pëlqimit.
Provë: Procesverbal i KEK-ut nr. 183466 datë 25.03.2009
- Me datë 06.05.2011 KEK-u ka lëshuar një urdhër lejimit / ngarkim nr. 33189 për shifrën DPR – 90054823 ku ka ngarkuar konsumatorin me një vlerë prej 3504.02€ dhe në të cilin urdhër lejim / ngarkim theksohet se: "*RCO1-s-Transfer borxhi nga shifrat paraprake për periudhën (13.02.2008 deri 03/2009) sipas vendimit nr. 162 të datës 05.05.2011*".
Provë: Urdhër lejimi / ngarkimi nr. 33189 i datës 06.05.2011
- Me datë 06.05.2011 KEK-u ka lëshuar një urdhër lejimit / ngarkim nr. 33190 për shifrën DPR – 90054823 ku ka ngarkuar konsumatorin me një vlerë prej 7760.08€ dhe në të cilin urdhër lejim / ngarkim theksohet se: "*RCO1-s-korrigjim diferenca në çmim dhe faturim i maksigrafit për faturën 08/2009 sipas vendimit nr. 162 të datës 05.05.2011*".
Provë: Urdhër lejimi / ngarkimi nr. 33190 i datës 06.05.2011



- Me datë 21.04.2011 KEK-u ka bërë shkyçjen e konsumatorit nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit të krijuar në shifrat paraprake.
Provë: Deklarata e konsumatorit
- Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar shkyçjen nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 06.05.2011 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në listat e leximit (periudha 01 - 04/2008) si dhe shpenzimet e asaj periudhe.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 06.05.2011
- Me datë 31.05.2011 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

DMK duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Konsumatori me datë 12.02.2009 ka parashtruar kërkesë zyrtare në KEK për regjistrimin e njehsorit elektrik.
Provë: Kërkesa e konsumatorit për regjistrimin e njehsori t e datës 12.02.2009
- ✓ Pëlqimin elektronenergjetik i është lëshuar konsumatorit Ruzhdi Kadriu "CITY Hipermarket", nga KEK-u me datë 10.03.2009, sipas së cilës matja e energjisë elektrike të bëhet me njehsor multifunksional (aktive, reaktive dhe maksigraf) i lidhur nëpërmes TMRR 400/5 A/A.
Provë: Pëlqimi elektronenergjetik nr. 84/ 2009 i datë 10.03.2009
- ✓ Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 25.03.2009 kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit dhe kanë evidentuar të dhënat teknike të pikës matëse si dhe kanë udhëzuar konsumatorin që brenda 3 - 5 dite të dorëzoj pëlqimin elektroenergjetik me qëllim që të bëhet legalizimi i matjes sipas pëlqimit.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 183466 datë 25.03.2009
- ✓ Me datë 06.05.2011 KEK-u përmes urdhër lejimit nr. 33189 ka bërë bartjen/transferimin e borxhit në vlerë prej 3,504.02€ nga disa shifra paraprake në shifrën e konsumatorit DPR – 90054823 dhe atë për periudhën 13.02.2008 deri më 03/2009 duke u bazuar në vendimin nr. 162 datë 05.05.2011. KEK-u me rastin e bartjes së borxhit në shifrën e konsumatorit DPR-90054823 është thirrur në shpenzuesit (39 njehsor individual), pasi që në objektin ku kanë qenë njehsorët e lartpërmendur nga data 13.02.2008 është pronë e konsumatorit Ruzhdi Kadriu, dhe se në atë objekt kanë kryer veprimtarin afariste disa lokale të vogla të cilët nuk i kanë pasivizuar njehsorët elektrik.
Provë: Urdhër lejimi nr. 33189 mbi bartjen/transferimin e borxhit në vlerë 3,504.02€
- ✓ Me datë 21.04.2011 KEK-u ka bërë shkyçjen e konsumatorit me shifër DPR - 90054823 nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit të krijuar në shifrat paraprake, por që konsumatorit nuk i është dërguar njoftimi për shkyçje si dhe arsyet e shkyçje siç parashihet me nenin 15 dhe 16 të Rregullës mbi shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë. Duhet theksuar se në transaksionet e konsumatorit të shifrës së konsumatorit DPR – 90054823 vërehet se nuk figuron ndonjë borxh i energjisë elektrike, dhe se bartja e borxhit/transferi ka ndodhur tek me datë 06.05.2011.
- ✓ Bazuar në transaksionet e konsumatorit konstatohet se bartja e borxhit nga 39 shifra në shifrën e re të konsumatorit është bërë me datë 06.05.2011 në vlerë 3,504.02 €, por që me datë 21.04.2011 kur edhe është bërë shkyçja e konsumatorit nga rrjeti elektrik vërehet se te shifra e konsumatorit DPR – 90054823 nuk ka pasur borxh të papaguar te energjisë elektrike.



Provë: Transaksionet e konsumatorit

- ✓ Konsumatori ka ofruar kontratën e blerjes së objektit “Urata Hipermarket” L.L.C nga AKM me të cilën vërtetohet se Z. Ruzhdi Kadriu nga data 13.02.2008 është pronar i vetme i objektit si dhe lirohet nga të gjitha borxhet e krijuara para blerjes së objektit.

Provë: Kontrata mbi shitblerjen e objektit nga AKM

- ✓ KEK-u ka ofruar listën e konsumatorëve me të cilat konstatohet se në piken matëse kanë ekzistuar 39 shifra të konsumatorëve duke evidentuar secilin konsumatorë si dhe borxhin total për secilin konsumator deri në periudhën 13.02.2008. Po ashtu evidentohet edhe borxhi i akumuluar nga periudha 13.02.2008 deri më 03/2009. Vlera e borxhit për secilin konsumator për periudhën 13.02.2008 deri më 03/2009 është 91.80 €, përveç konsumatorit me shifër DPR - 90025677 ku sipas transaksioneve vërehet se është 107.67€, si dhe konsumatorit me shifër DPR - 90030283 i cili nuk ka borxh. Sipas listës së ofruar nga KEK-u vlera totale e borxhit për periudhën 13.02.2008 deri më 03/2009 është 3,504.02 €.

- ✓ DMK me datë 02.12.2011 ka kërkuar nga KEK-u procesverbalin e shkyçjes së konsumatorit nga rrjeti elektrik, por KEK-u nuk ka ofruar dokumentin e kërkuar. Po ashtu bazuar në transaksionin e konsumatorit nuk figuron ngarkesa e shkyçjes së konsumatorit nga rrjeti elektrik.

Provë: Kërkesa e DMK-së e datës 02.12.2011

- ✓ Rregulla për shkyçje dhe rikyçje në sektorin e energjisë në Kosovë përcakton hapat të cilat kompania e energjisë duhet ti ndjek para ekzekutimit të shkyçjes komerciale. Neni 15 i kësaj rregulle përcakton mënyrën e paralajmërimit për shkyçje të konsumatorit përkatësisht neni 15.2. “Njoftimi paralajmërues do të përfshijë njoftimin mbi masat që do të ndërmerren ndaj konsumatorit përfshirë shkyçjen , në rast se ai nuk kryen veprimet e specifikuar në paralajmërim, brenda një afati të përcaktuar kohor. Ajo periudhë kohore nuk mund të jetë më pak se pesëmbëdhjete (15) ditë kalendarike prej datës së paralajmërimit të konsumatorit” si dhe neni 16 thekson që “Pas kalimit të afatit përfundimtar të përcaktuar në njoftimin paralajmërues sipas nenit 15.2, ndërmarrja e energjisë është e obliguar të dërgojë te konsumatori një njoftim për shkyçje para se të ndërmarrë veprimin për shkyçje.

Provë: Rregulla për shkyçjen dhe rikyçje në sektorin e energjisë në Kosovë

- ✓ DMK ka analizuar transaksionet e shifrave të konsumatorëve të vendosur në objektin e privatizuar nga AKM, dhe konstaton se të gjitha shifrat e konsumatorëve për periudhën 13.02.2008 deri më 03/2009 janë ngarkuar vetëm me taksa, e jo me shpenzim. Po ashtu sipas rrjedhës së energjisë elektrike aktive konstatohet se nga periudha 02/2008 në pikat matëse nuk ka pasur shpenzim të energjisë elektrike.

- ✓ Konsumatori ka ofruar shkresën lëshuar nga AKM me datë 09.11.2007 me të cilën vërtetohet se blerësi z.Ruzhdi Kadriu i është drejtuar Agjensionit për privatizim me qëllim të sqarimit së çështjes së hapësirave të uzurpuara të objektit nga lokalet e ndryshme. Në përgjigjen e dhënë AKM sqaron se nga data 12 nëntor 2007 do të bëjë çmos për të njoftuar uzurpatorët se objekti duhet të lirohet nga ta.

Provë: Shkresa e lëshuar nga AKM e datës 12.11.2007

- ✓ Konsumatori ka ofruar shkresën drejtuar stacionit policor në qendër-Prishtinë me datë 10.03.2008 me të cilën kërkon nga policia e Kosovës që të ndihmoj në largimin nga prona të uzurpatorit, kafiteri “Diana” e cila ka uzurpuar një pjesë të hapësirës së objektit me sipërfaqe prej 100 m².

Provë: Shkresa drejtuar policisë, stacioni qendër-Prishtinë

- ✓ KEK-u në përgjigjen e tyre ka theksuar se refuzohet ankesa e konsumatorit pasi që sipas AKP pronar i ri i objektit nga data 13.02.2008 është Ndërmarrja Urata Hipermarket. Sipas KEK-ut



konsumatori është furnizuar nga 39 njehsor individual dhe se nuk është lajmëruar në KEK madje nuk u lejuar punëtorëve të KEK-ut të lexojnë njehsorët elektrik. Pas një viti lajmërohet konsumatori në KEK për herë të parë për regjistrimin e njehsorit elektrik. Sipas KEK-ut theksohet se KEK-u konsumatori nuk i përfillur dispozitat ligjore duke mos i shpërfillur. KEK-u ka bërë prerjen e gjendjes financiare prej periudhës 13.02.2008 deri më 03/2009 në vlerë prej 3504.02€. Pas kësaj KEK-u i ka dhënë pëlqimin elektroenergjetik në të cilin theksohet se në objektin në të cilin tani ekziston objekti më parë kanë ekzistuar edhe disa njehsor tjerë. KEK-u në përgjigje ka theksuar se punëtorët e autorizuar të KEK-ut e kanë njoftuar konsumatorin për borxhin e pikave matëse të krijuara pas marrjes në pronësi të objektit. **Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 06.05.2011

- ✓ Me privatizimin e objektit nga APM (tani AKP) konsumatorit me shifër DPR – 90054823 është bërë pronar i objektit nga data 13.02.2008. Konsumatori ka ofruar dokumente me të cilat ka ofruar se objekti ka qenë i uzurpuar nga persona tjerë. Shkycja e konsumatorit ka ndodhur në prill të vitit 2011 ndërsa bartja e borxhit ka ndodhur me datë 06.05.2011. KEK-u thekson se ka bërë bartjen e borxhit prej periudhës 13.02.2008 deri më 03/2009 me datë 06.05.2011, pra sipas KEK-ut kjo bartje është bërë përafro dy (2) viteve. KEK-u ka qenë në dijeni se nuk është bërë mbyllja e llogarive të shifrave të mëparshme dhe se nëpër ato shifra ka shkuar vetëm taksa e jo edhe shpenzim. Konsumatori ka aplikuar për regjistrim të njehsorit të ri dhe shifrës së re dhe se KEK-u konsumatorit i ka hapur shifër të re dhe ia ka regjistruar njehsorin e ri elektrik

DMK duke u bazuar në analizat e bëra dhe argumentet e paraqitura, në veçanti mos ofrimin e procesverbalit të shkycjes të datë 21.04.2011, mos njoftimin e konsumatorit për shkycje, bartjen e borxhit pas shkycjes së konsumatorit nga rrjeti elektrik dhe dokumentacionin e AKM, ka rekomanduar Bordin e ZRRE-së që të **aprovojë** ankesën e konsumatorit dhe vjen në përfundim se:

1. KEK-u duhet të shkarkoj konsumatorin Shifrën nga korrigjimi nr. 33189 i datës 06.05.2011 në vlerë 3504.02 €.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që të **aprovojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. KEK-u duhet të shkarkojë konsumatorin shifrën DPR - 90054823 nga korrigjimi nr. 33189 i datës 06.05.2011 në vlerë 3504.02 €.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Enver Halimi, anëtar